



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo



NDIHMJA JURIDIKE | PRAVNA POMOC
LEGAL AID

AGJENCIA PËR NDIHMË JURIDIKE FALAS
AGENCIJA ZA BESPLATNU PRAVNU POMOC
AGENCY FOR FREE LEGAL AID

DATË/A:	10.03.2017
REFERENC-Ë:	
PËR/ZA/TO:	Z. Salvador Elmazi - Drejtor i Departamenti i Buxhetit
CC:	Agjencia për Ndihme Juridike Falas
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Z. Ramadan Gashi - Drejtor Ekzekutiv
NGA/OD/FROM:	Z. Daut Morina - Drejtor i Administratës Qëndrore
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2018-2020

Të nderuar,

Agjencia për Ndihmë Juridike Falas (ANJF) më datën 03.03.2017 ka pranuar Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) që mbulon vitin e ardhshëm fiskal 2018 dhe jep vlerësimet për dy vitet vijuese (2019-2020) me numër të protokollit 01/599 të datës 28.02.2017 sipas së cilës kërkohet nga organizatat buxhetore të paraqesin Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2018-2020.

KORNIZA AFATMESME E SHPENZIMEVE 2018-2020

1. Misioni

Agjencia për Ndhimë Juridike Falas është e përkushtuar të ofrojë ndihmë juridike falas, duke siguruar qasje të barabartë në drejtësi për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, veqanërisht për grupet e marginalizuara dhe do të :

- ❖ Bashkëpunojë me të gjithë ofruesit e ndihmës juridike falas duke përmirësuar komunikimin ndërmjet ofruesve të ndihmës juridike falas dhe përfituesve të saj ;
- ❖ Ngrit vetëdijen e qytetarëve për punën e Agjencisë dhe njohja e nevojave të tyre ;
- ❖ Siguron mjete materiale financiare të nevojshme për funksionimin e mirëfilltë të ANJF-së dhe siguron se ANJF-ja ofron ndihmë juridike falas në pajtim me ligjet vendore dhe aktet ndërkombëtare;
- ❖ Ndërmerr hapa të sigurt në përmirësimin e strukturës legislative, me të cilën rregullohet fusha e ndihmës juridike falas dhe rrit nivelin e administrimit operativ të ANJF-së .

2. Situata aktuale

Agjencia për Ndhimë Juridike Falas aktualisht është e shtrirë në 5 (pesë) komuna rajonale dhe atë në : Selia dhe Zyra Rajonale për Ndhimë Juridike Falas në Prishtinë, ZRNJF në Mitrovicë, ZRNJF në Pejë, ZRNJF në Prizren dhe ZRNJF në Gjilan.

Agjencia për Ndhimë Juridike Falas që nga muaji Prill 2017 do të ketë edhe dy zyre te reja dhe atë : ZRNJF në Ferizaj dhe ZRNJF në Gjakovë, duke ju mundësuar kështu qytetarëve të këtyre komunave të kenë qasje më të lehtë për Ndhimë Juridike e drejtë kjo e cila ju garantohet me Kushtetutën e Republikës së Kosovës neni 31, paragrafi 6 dhe me Ligjin Nr 04-L/017 për Ndhimë Juridike Falas, neni 4 dhe neni 22, ku parashihet se ANJF duhet të ofrojë ndihmë juridike falas në tërë territorin e Republikës së Kosovës nëpërmjet zyrave rajonale për ndihmë juridike falas.

Ligji Mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë parashehë në mënyrë të qartë nevojën për plotësimin e disa pozitave:

- Drejtor i Departamentit për Shërbime Juridike 1 (një pozitë)
- Zyrtar për Ndhimë Juridike 3 (tri pozita)
- Zyrtar Zotues 1 (një pozitë)
- Zyrtar Certifikues 1 (një pozitë).

Duke marr parasysh numrin e kërkesave të palëve për shërbimet e ndihmës juridike falas, në zyrën Rajonale për Ndhimë Juridike Falas në Prishtinë, Mitrovicë dhe Prizren kemi mungesë për nga 1 (një) zyrtar për ndihmë juridike falas për secilën zyre të lartcekur, për një zyrtar zotues si dhe një zyrtar certifikues, andaj kërkojmë që në përputhje me Organogramin e ANJF-së të aprovohet shuma për pagesën e pozitave të lartcekura (Drejtor i Departamentit për Shërbime Juridike si dhe 5 zyrtar të tjerë). Kosotoja vjetore për këto pozita është 35,875.33 €.

Objektivat

Objektivat e planit strategjik janë mjete përmes së cilave Agjencia synon të realizoj qëllimet e veta. Planit strategjik është i përqëndruar në katër shtylla të ndara, të cilat i mundësojnë Agjencisë të kryej obligimin e vet kushtetues për ofrimin e ndihmës juridike falas të gjithë qytetarëve të cilët kanë nevojë për ndihmë juridike.

1. Shtylla I –komunikimi dhe bashkëpunimi- *Qasja e bashkëpunimit ndërmjet Agjencisë dhe partnerëve të caktuar është thelbësore në zhvillimin e politikës komunikuese, duke siguruar qasje të barabartë në drejtësi për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës. Për më tepër, në mënyrë që të sigurohet qasje e barabartë në drejtësi për të gjithë qytetarët, ata kanë nevojë të dijnë se cilat janë të drejtat e tyre, dhe të informohen për mekanizmat ekzistues, se ku mund të drejtohen në qoftë se mendojnë se u është shkelur ndonjë e drejtë e tyre.*

Aktivitetet specifike që përdoren për arritjen e kësaj objektivë janë:

1.1. Bashkëpunimi me ofrues të ndihmës juridike falas, përmirësimi i komunikimit dhe ndihma ndaj përfituesve.

Kjo arrihet duke krijuar **rrjetin e resurseve dhe metodat për komunikim** me partnerët kryesor dhe ofruesit e ndihmës juridike falas. Agjencia është e përkushtuar të bëjë hulumtim në mënyrë që të identifikoj përfituesit dhe shpenzimet e mundshme, sigurimi i informatave të sakta për fushat e specializuara të ofruesve tjerë të Ndihmës Juridike Falas, territoret të cilat ato mbulojnë, në mënyrë që ta ketë më të lehtë referimin e rasteve tek këta ofrues të shërbimeve juridike që veprojnë në interes të qytetarëve (p.sh. grupet e targetuara, viktimat e dhunës dhe trafikimit, qendrat e këshillimit, strehimoret etj). Pas identifikimit të partneritetit të mundshëm, do të nënshkruhet Marrëveshja e Mirëkuptimit me institucionet përkatëse në pajtim me nenet 29-30 të Ligjit për Ndihmë Juridike, dhe Agjencia synon të mbajë takime të rregullta në mbarë Kosovën, duke fuqizuar kështu rrjetin e bashkëpunimit.

1.2. Ngritja e aftësive për komunikim, dhe vetëdijësimi i qytetarëve për punën e Agjencisë dhe kuptimi i nevojave të tyre

Nga stafi i personelit përcaktohet përgjegjësi për marrëdhënje me publikun. Agjencia do të: 1) përditësojë materialët informuese për qytetarët; 2) organizojë takime me përfaqësues të asambleve komunale; dhe 3) dizajnojë dhe organizojë kampanja të ndryshme mbi të drejtat për qasje në drejtësi. Gjithashtu Agjencia tashmë ka të hapur ueb-faqen e saj si dhe faqen e Facebook-ut. Në këtë mënyrë, me qëllim të bashkëveprimit të Agjencisë me të tjerët do të shkëmbehen informata për projekte e aktivitete aktuale në interes të publikut, dhe do rris kapacitetet për bashkëveprim të qëndrueshëm dhe të rregullt me qytetarët.

2. Shtylla II- Menaxhimi financiar - *Financimi është mjet i nevojshëm për çdo organizatë për të implementuar në mënyrë efektive mandatin dhe funksionin e saj. Sigurimi i resurseve të qëndrueshme dhe të mjaftueshme për Agjencinë është një ndër elementet kryesore, për të mundësuar dhe plotësuar nevojat e përfituesve potencial të ndihmës juridike falas. Për arritjen e kësaj objektivë*

Agjencia përdor këto strategji:

2.1. Sigurimi i resurseve të nevojshme financiare për të përmbushur obligimet ligjore të Agjencisë

Agjencia përgaditë në mënyrë permanente propozim buxhetin për Ministrinë e Financave. Hapat që Agjencia do ndërmerret për të arritur këtë qëllim Strategjik do të përfshijnë vlerësimin e punës së saj, nevojat financiare, që në mënyrë të duhur të konstatoj nevojat ligjore për ndihmë juridike të qytetarëve të Kosovës dhe një analizë krahasuese të fondeve të cilat ndahen për subjektet tjera të cilët veprojnë në fushëveprime të ngjashme. Agjencia është e vetëdijshme se për të siguruar fonde shtesë duhet t'i prezantojë qeverisë dhe donatorëve të mundshëm ndërkombëtar, se kërkesat për mjete dhe realizimi i tyre financiar është i arsyeshëm dhe do të ndikojë pozitivisht për realizimin e qasjes së barabartë në drejtësi të qytetarëve, të cilët nuk kanë mundësi të paguajnë shërbime profesionale juridike.

2.2 Rritja e efikasitetit administrativ dhe financiar –Praktika më e mirë e menaxhimit është shqyrtimi dhe vlerësimi i kohëpaskohshëm i strukturës administrative. Agjencia me ndihmën e ekspertëve qeveritarë dhe ndërkombëtarë rishikon pozitat e brendshme administrative për efikasitetin e punës së tyre. Agjencia do të mbaj takime të rregullta të menaxhmentit udhëheqës, në mënyrë që të sigurojë komunikimin sa më efektiv, si dhe zbatimin e rezultateve të vlerësimit për çështjet administrative dhe financiare.

2.3 Rritja e bashkëpunimit me organizatat tjera qeveritare, që ofrojnë qasje në shërbimet e drejtësisë

Të shqyrtohen mundësitë e bashkë-menaxhimit të rasteve me Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Ministrinë e Drejtësisë, Odën e Avokatëve të Kosovës, Zyrën për Mbrojtje të viktimave dhe /apo me zyrën e Ndërmjetësimin. Shqyrtimi i mundësive për zbatimin e pilot-ideve për të ngritur efikasitetin e menaxhimit të rasteve.

3. Shtylla III- Menaxhimi i rasteve- Menaxhimi i mirë dhe efikas i rasteve nga Agjencia do të ndihmojë në sigurimin që fondet e siguruar nga Agjencia të përdoren në mënyrë sa më efektive dhe efektive. Për të arritur këtë, është i nevojshëm trajnimi (ngritja e kapaciteteve të personelit të Agjencisë, për ofrimin e ndihmës juridike falas), në mënyrë që personeli të ketë performancë më të lartë në kryerjen e detyrave të tyre.

Aktivitetet specifike që përdoren për arritjen e kësaj objektive janë:

3.1.Përditësimi dhe/ose krijimi i procedurave të reja operative – Puna me qendrat rajonale të Agjencisë dhe subjektet tjerë vendor dhe ndërkombëtar për të rishikuar dhe sipas nevojës të përditësohen procedurat standarde operative, që kanë të bëjnë me funksionet e ndryshme organizative.

3.2.Rritja e disponueshmërisë së mundësive përkatëse, aftësive dhe njohurive- bazë të trajnimit për personelin e Agjencisë.- Për efikasitet më të lartë të personelit të Agjencisë, është e domosdoshme trajnimi për të drejtën materiale dhe procedural,menaxhimi i rasteve, hulumtim dhe shkrim ligjor.Agjencia do të bashkëpunojnë me institucione tjera vendore të trajnimit dhe partnerët ndërkombëtarë për të përcaktuar programe trajnimi për personelin e Agjencisë të përfshirë në ofrimin e ndihmës për palë.

3.3. **Përfshirja e qasjes së përqëndruar ndaj palëve gjatë vlerësimit të performancës së personelit.**- Zhvillimi i pyetësorit për të vlerësuar kënaqëshmërinë e palëve me ofruesit e shërbimeve, përfshirja e anketimeve të kënaqëshmërisë dhe matjet tjera, që vlerësojnë kualitetin e performancës së personelit.

4. Shtylla IV– Korniza ligjore dhe e politikave - Si shtesë e një programi të mirëfilltë, korniza legislative e përshtatur në mënyrë që të përmbush nevojat e qytetarëve, rritë mundësinë e saj për të pasur ndikim pozitiv në shoqëri.

4.1. **Përmirësimi i kornizës ligjore që rregullon ndihmën juridike falas.** – Themelimi i grupit punues Brenda Agjencisë, i përbërë nga personeli i menaxhmentit dhe zyrtarë rajonale për ndihmë juridike falas, që do të kenë për detyrë të analizojnë ligjin dhe nëse ka nevojë t'i propozojë amendamente konkrete Ministrisë së Drejtësisë. Pa marrë parasysh se a janë zbatuar me sukses ndryshimet në kornizën legislative, nevojitet një vlerësim i Agjencisë për zbatimin formal të ligjit ekzistues për ndihmën juridike falas. Andaj, me ndihmën e institucioneve vendore dhe ndërkombëtare Agjencia do të udhëheqë një vlerësim të akteve nën-ligjore të lëshuara nga Agjencia, apo për të përcaktuar se ku/nëse duhet të bëhen rregullime apo amendamente shtesë të akteve nën-ligjore ekzistuese. Vlerësimi duhet të ofrohet Bordit i cili cakton afatin kohorë, brenda të cilit Agjencia duhet t'i draftojë aktet normative paraprakisht të propozuara nga Bordi.

1. Trendet e financimit 2016-2017 dhe vlerësimet 2018-2020

Tabela 1: Trendet e financimit 2016-2017 dhe vlerësimet 2018-2020

Organizata Buxhetore	Viti 2016 Shpenzimi	2017 Buxhetuar	2018 Vlerësuar	2019 Vlerësuar	2020 Vlerësuar
Total					
Nr I punëtorëve	21	26	26	26	26
Pagat dhe Mëditjet	155,873.31	190,715.97	191,668.95	192,626.98	193,585.01
Mallra dhe Shërbime	123,236.14	128,192.00	128,192.00	128,192.00	129,141.00
Shpenzimet Komunale	7,553.96	14,917.00	14,917.00	14,917.00	14,917.00
Subvencionet dhe Transferet					
Shpenzimet Kapitale					
Burimet e Financimit					
Grantet Qeveritare	300,825.00	333,824.97	334,777.95	335,735.98	337,643.01
Te hyrat vetanake					
Financimet nga huamarrjet					
Grantet nga Donatorët	28,220.76				

*Grantet nga donatorët nuk janë pjesë e totalit të Shpenzimeve sipas Burimeve të Financimit.

Tablea 2. Propozimet për politika të reja të organizatës buxhetore

Politika e re prioritare 1.	Viti 2018 Vlerësuar	Viti 2019 Vlerësuar	Viti 2020 Vlerësuar
Pershkrimi			
Nderlidhja e politikës se re me Deklaratën e Prioriteteve Aftmesme 2018-2020			
Nr I punëtorëve	6	6	6
Pagat dhe Mëditjet	35,875.33	35,875.33	35,875.33
Mallra dhe Shërbime	30,000.00	30,000.00	30,000.00
Shpenzimet Komunale			
Subvencionet dhe Transferet			
Shpenzimet Kapitale			
Burimet e Financimit			
Grantet Qeveritare	65,875.33	65,875.33	65,875.33
Te hyrat vetanake			
Financimet nga huamarrjet			

**Grantet nga donatorët nuk janë pjesë e totalit të Shpenzimeve dipas Burimeve të Financimit.*

Sa i përket të dhënave në tabelën 2 (e dytë) janë kalkuluar 6 pozita të reja të cilat janë :

- Drejtor i Departamentit për Shërbime Juridike 1(një pozitë)
- Zyrtar për Ndihmë Juridike 3(tri pozita)
- Zyrtar Zotues 1(një pozitë)
- Zyrtar Certifikues 1(një pozitë) si dhe
- Shpenzimet për Klinikën Mobile

Ligji Mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë parashehë në mënyrë të qartë nevojën për plotësimin e pozitave të lartcekura.

Sa i përket angazhimit të avokatëve për vitet e ardhshme, konsiderojmë të nevojshme shtimin e buxhetit për 10,000.00 € , sepse obligimet barten nga vitet paraprake.

ANJF-ja ka nevojë për buxhet shtesë në mënyrë që të arrijë të funksionalizoj klinikën mobile (të cilën e kemi donacion nga UNDP-ja e cila është e pa aktivizuar) për ofrimin e ndihmës Juridike, në komunat e ndryshme të Kosovës në të cilat nuk kemi zyre të hapura në pajtim me nenin 2 të Ligjit me Nr.04/L-017 për Ndihmë Juridike Falas. Kostoja e ofrimit të ndihmës Juridike nëpërmjet klinikës mobile është 20,000.00 €.

Ju faleminderit për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.

Me respekt,

Daut Morina

Drejtor i Administratës Qëndrore

Tel: 200 18 943

Mob: 044 139 213

Email: daut.morina@rks-gov.net